



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

**Data:14/11/2019**

**Nr.54/19**

Duke u bazuar në neni 28, 29 dhe çështjet procedurale, të përcaktuara sipas nenit 13,15,17,19,20,35,50,54 paragrafi 1.3 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe Neni 8 i Plotësim Ndryshimit të Ligji nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi 1.3 për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës në mbledhjen e datës, 14.11.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. LEJOHET**, Përqendrimi i Pozavarovalnica Sava d.d. dhe Zavarovalnica Triglav d.d., për fitimin e kontrollit të përbashkët mbi Diagnostični center Vila Bogatini d.o.o. , me adresë në Pod Skalo 4, 4260 Bled. "Pogodba o Prodaji in Prenosu Poslovnega Deleža v Družbi Diagnostični Center vila Bogatini d.o.o.," e lidhur me 08.08.2019, nga CIXRO HOLDINGS LIMITED, si shitës, dhe SavaRe si blerës; lidhur ndërmjet Triglav dhe SavaRe , me 8 gusht 2019; Vendimi i Bordit Mbikëqyrës të Triglav për fitimin e 40% të kapitalit aksionar në Diagnostični Center Vila Bogatini d.o.o" dhe Memorandumi i Inkorporimit të ZRSR, Raziskovanje trga, d.o.o, i ndryshuar me 23.08.2019, **SavaRe** është shoqëri aksionare, me numër të regjistrimit të biznesit 5063825000, me numër identifikues të TVSH-së SI17986141 me adresë të regjistruar në Rruga Dunajska cesta 56 (p.p.b 318),1001 Ljubljana, Slloveni. SavaRe në territorin e Republikës së Kosovës ka në pronësi; **I.Kompanin e sigurimeve,Illyria Sh.A.**, e cila është shoqëri aksionare me numër unik identifikues 810483769 dhe numër të regjistrimit të biznesit70152892,me adresë të regjistruar në Sheshin Nëna Terezë Nr.33,10000 Prishtinë,me aktivitete të biznesit sigurimin jo-jetësor; dhe **II.Kompania për Sigurimin e Jetës Illyria –Life Sh.A.**, shoqëri aksionare me numër unik të identifikues 810733837 dhe numër të regjistrimit të biznesit 70520893 dhe me adresë të regjistruar në Sheshi Nëna Terezë Nr. 33, 10000 Prishtinë, me aktivitete të biznesit sigurimin jetësor,si dhe **III. Illyria Hospital Sh.P.K.**,shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër të regjistrimit të biznesit 70587513, me adresë të regjistruar,në

Sheshi Nëna Terezë Nr.33,10000 Prishtinë, me aktivitete të biznesit: aktivitetet e mjeksisë së përgjithshme, tregtia me shumicë jo të specializuar, tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjeksorë, në dyqane të specializuara, aktivitetet e dentistëve, tregtia me pakicë e artikujve farmaceutik. Ndonëse aktivitetet e lartpërmendura janë të regjistruara si aktivitete të biznesit të Illyria Hospital Sh.P.K., për momentin Illyria Hospital nuk kryen asnjë nga këto aktivitete në Kosovë. **Triglav** është shoqëri aksionare, me numër të regjistrimit të biznesit 5063345000, me numër të TVSH-së 80040306 dhe me adresë të regjistruar në Rruga Miklosiceva cesta 19, 1000 Ljublanë. **ZTSR raziskovanje trga, d.o.o.**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër të regjistrimit të biznesit 8281262000, me adresë të regjistruar në Dunajska cesta 22, 1000 Ljublanë, Slloveni, me aktivitete të biznesit hulumtimin e tregut. **DCB**, Diagnostični center vila Bogatini d.o.o është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër të regjistrimit të biznesit 5690366000, numër të TVSH-së SI 41736354 dhe adresë të regjistruar në Pod Skalo 4, 4260 Bled, Slloveni. Aksionarë i vetëm i DCB është CIXRO HOLDINGS LIMITED, i themeluar sipas Republikës së Qipros, me numër të regjistrimit të biznesit HE 332752 dhe adresë të regjistruar në Kyriakou Matsi, 16 Eagle House, Kati 10, 1082, Nikozi, Qipro. DCB operon vetëm në tregun Sllovenë. Në këtë kuptim, ka në pronësi 100% të kapitalit aksionarë në kompanit; **Gastromedica Institut za Bolezni Prebavil d.o.o**, **Internistična ge Ambulanta d.o.o**, **Medicinsko Termalini Center Fontala**, **Zdravstovo in Rekreacija, d.o.o**. **Medi Cons Kardiologija d.o.o**.

**II. Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim** obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 €, me shkronja (Njëqind Euro), ndërsa Autorizimi për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe nenit 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 €, me shkronja (tre mijë euro).

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni.

## ARSYETIM

---

1. Me datë 06.09.2019 Autoriteti ka pranuar kërkesën e Njoftimit për Përqendrim të Pozavarovalnica Sava d.d. dhe ZAVAROVANICA TRIGLAV d.d., për fitimin e kontrollit të përbashkët mbi Diagnostični center Vila Bogatini d.o.o., me adresë në Pod Skalo 4, 4260 Bled. Kërkesa është paraqitur në bazë të Ligjit Nr.03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji Nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve.

Procedurat e ndjekura nga Autoriteti:

- a) Njoftimi i përqendrimit në Web Faqen e Autoritetit me datën, 30.01.2019 ;
- b) Vërtetimi, me të cilin Autoriteti ka konsideruar lëndën të plotësuar me datën 18.09.2019.
- c) Autoriteti ka bërë vlerësimin e qëllimit të realizimit të Përqendrimit sipas procedurës së shkurtër.

**Njoftimi për Përqendrim ka të bëjë me:**

2. Përqendrimin (“Transaksioni”),ka të bëjë me Pozavarovalnica Sava d.d. dhe ZAVAROVANICA TRIGLAV d.d., për fitimin e kontrollit të përbashkët mbi Diagnostični Center Vila Bogatini d.o.o.. Me datën 8 gusht 2019, SavaRe dhe CIXRO HOLDINGS LIMITED, lidhën marrëveshjen . ”Pogodba o Prodaji in Prenosu Poslovnega Deleža v DRUŽBI Diagnostični center vila Bogatini d.o.o.,” tash e tutje referuar si **“Marrëveshja për Shitëblerjen e DCB”** mbi bazën e të cil cilës SavaRe do të blejë 80.1312% të aksionëve , përkatësisht 100% të të drejtave të votimit, në Diagnostični Center vila Bogatini d.o.o me adresë në Pod Skalo 4,4260 Bled, Slloveni, tash e tutje referuar si **“DCB.”** Në Marrëveshja për Shitëblerjen e **DCB** , shitësi, CIXRO HOLDINGS LIMITED , ka dhënë shprehimisht pëlqimin e tij që kjo marrëveshje të transferohet tek ZTSR raziskovanje trga, d.o.o., me adresë të regjistruar në Dunajska cesta 22, 1000 Ljubljana, Slloveni, tash e tutje e referuar si **“ZTSR.”** Me 8 gusht lidhën “Sporazum o Načinu Sodelovanje Pri Pridobivanju Udeležbe v D ružbi Diagnosticni Center Vila Bogatini d.o.o.,” tash e tutje si **“Marrëveshja e Palëve Njoftuese mbi Fitimin e Përbashkët të Aksionëve në DCB.”** Sipas Marrëveshjes së Palëve Njoftuese mbi Fitimin e Përbashkët të Aksionëve në DCB , palet në këtë transaksion kanë për qëllim të fitojnë kontroll direkt mbi DCB në mënyr indirekte nëpërmjet ZTSR, dhe në rast se kjo nuk është e mundur ,në mënyr direkte. **SavaRe** është shoqëri aksionare ,me numër të regjistrimit të biznesit 5063825000, me numër identifikues të TVSH-së SI17986141 me adresë të regjistruar në Rruga Dunajska cesta 56 (p.p.b 318),1001 Ljubljana, Slloveni. **Triglav** është shoqëri aksionare,me numër të regjistrimit të biznesit 5063345000,me numër të TVSH-së 80040306 dhe me adresë të regjistruar në Rruga Miklosiceva cesta 19,1000 Ljubljana,Slloveni **ZTSR raziskovanje trga,d.o.o.**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ,me numër të regjistrimit të biznesit 8281262000,me adresë të regjistruar në Dunajska cesta 22,1000 Ljubljana,
3. **SavaRe** ka në pronësi këto kompani edhe në Kosovë, të regjistruara sipas ligjeve të Republikës së Kosovës e identifikuar si **1.Kompania e sigurimeve Illyria Sh.A**, me një kapital të paguar prej [REDAKTUAR] **2. Kompania për Sigurimin e Jetës Illyria –Life Sh.A**, me një kapital të paguar prej [REDAKTUAR] **3. Illyria Hospital Sh.P.K** ,për momentin nuk kryen asnjë aktivitet në Republikën e Kosovës.

4. Të hyrat e përgjithshme lokale të këtyre kompanive në territorin e Republikës së Kosovës, për vitin 2018 janë [REDACTED].

### **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit**

5. Bazuar në nenin 15, të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, palët kanë përmbushur detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:
  - a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në mbarë botën, kalon shumë më 20 milion EURO
  - b) Blerësi është i regjistruar në Republikën e Kosovës.
  - c) Kontrata e Shitblerjes, datë 08.09.2019.

### **Analiza e Tregut**

#### Tregu Relevant

- **Tregu gjeografik** në transaksionin e propozuar do të jetë territori i Republikës së Sllovenisë.

#### Ndërsa

- **Tregu i produktit**, përfshin produktet e kujdesit shëndetësor spitalor dhe jashtë spitalor.  
Sipas vlerësimi

### **Pjesët e tregut dhe nivelet e përqendrimit**

6. Përqendrimet jo-horizontale, nuk përbëjnë një kërcënim për konkurrencën efektive, vetëm nëse njësia e përqendruar ka një shkallë të konsiderueshme të fuqisë në treg, në të paktën një nga tregjet përkatëse, por kjo nuk do të thotë se njësia e përqendruar duhet të ketë pozitë dominuese të produkteve e kujdesit shëndetësor spitalor dhe jashtë spitalor.

### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar**

7. Përqendrimi është propozuar në Slloveni, por kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se njëri nga blerësi degën e saj të regjistruar në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara vërejmë se targeti DCB nuk ka degë të regjistruar në tregun e Republikës së Kosovës, dhe si i tillë nuk ka mundësi të bëhet ndryshim në strukturën ( horizontale apo vertikale ).
8. Autoriteti vlerëson se ky përqendrim nuk ka mbivendosje horizontale ose efekte vertikale sepse ndërmarrjet operojnë në tregje të ndara.

9. Autoriteti shqyrtoi dhe arriti në përfundimin se nuk ka efekte negative nga realizimi i këtij përqendrimi sepse asnjëri nga pjesëmarrësit në përqendrim nuk vepron në tregun e njëjtë relevant dhe në mes tyre nuk ka marrëveshje horizontale, rrjedhimisht asnjëri nga pjesëmarrësit nuk vepron në tregun në të cilin rëniet dhe ngritjet, në raport me tregun në të cilin vepron pjesëmarrësi tjetër i përqendrimit nuk ka lidhje vertikale dhe transaksioni nuk do të ketë efekt në konkurrencë, në Republikën e Kosovës.
10. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe ky transaksion nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun e Republikës së Kosovës.
11. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve dhe se i njëjti, nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun e Republikës së Kosovës.

Vëmendje:

*Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës respektivisht sjellje anti – konkurruese dhe ndikimi i Holdingut SavaRe, në përfaqësitë e saj në Republikën e Kosovës, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.*

Kërkesa për Përqendrim merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

**KOMISIONI  
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

(\_\_\_\_\_)  
Valon Prestreshi  
Kryetar

(\_\_\_\_\_)  
Ahmet Krasniqi  
Zv. Kryetar

(\_\_\_\_\_)  
Fatime Haziri  
Anëtare

(\_\_\_\_\_)  
Muhamed Krasniqi  
Anëtar

(\_\_\_\_\_)  
Shaqir Morina  
Anëtar

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva